



## **Këtë javë në komisionet parlamentare**

### **■ U shqyrtuan 12 nisma ligjore të rëndësishme:**

#### **- 7 Projektligje:**

- “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin për reagimin ndaj emergjencës COVID-19 në Shqipëri”;
- “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin për Zhvillimin e Turizmit dhe Infrastrukturës në Shqipëri”;
- “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për reagimin ndaj emergjencës COVID-19 në Shqipëri”;
- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”;
- “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”;
- “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”;
- “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" të ndryshuar.

#### **- 2 Dekrete të Presidentit të Republikës**

- Dekreti i Presidentit nr. 11.841, datë 20.11.2020 "Për kthimin e ligjit nr 133/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 108/2014 "Për Policinë e Shtetit, të ndryshuar”;
- Dekreti i Presidentit nr. 11811, datë 5.11.2020, “Për kthimin e ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”.

#### **- 3 projektvendime**

- Projektvendimet për disa shtesa dhe ndryshime në strukturën dhe organikën e institucionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit dhe zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### **Kuvendi miratoi 4 projektligje dhe një projektvendim. U rrëzua një Dekret i Presidentit të Republikës**

Kuvendi u mbledh në seancë plenare dhe miratoi 4 projektligje:

- “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar””,
- “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin për reagimin ndaj emergjencës COVID-19 në Shqipëri”,
- “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për bashkëpunim ekonomik” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”;
- “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për bashkëpunim ekonomik” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”. “Për ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX Facility)”;

Seanca miratoi edhe projektvendimin “Për miratimin e përbërjes së komisionit të posaçëm të Kuvendit “Për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues mbi gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri mbi çështjet e raportit të anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Dick Marty mbi bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur, përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Kuvendi votoi kundër Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11.841, datë 20.11.2020 “Për kthimin e ligjit nr. 133/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar””.

## Aktivite parlamentare

### **Ambasadorja e Shtetit të Palestinës i dërgoi letër urimi znj. Mimi Kodheli, me rastin e zgjedhjes Zëvendësprezidentë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s**

**2 Dhjetor 2020** - Ambasadorja e Shtetit të Palestinës, znj.Hana A.S.Shaëa, i ka dërguar një letër urimi deputetes Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit të Politikës së Jashtëm, me rastin e zgjedhjes së saj si Zëvendësprezidentë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. “Është nder dhe kënaqësi për mua t’i përcjell Shkëlqesisë Suaj përgëzimet dhe urimet më të ngrohta për zgjedhjen Tuaj Zëvendësprezidentë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Në emër të Ambasadës së Shtetit të Palestinës në Republikën e Shqipërisë si edhe në emrin tim personal i uroj Shkëlqesisë Suaj suksese në detyrën Tuaj të re si edhe në përpjekjet Tuaja. Me këtë rast dëshiroj të ritheksoj vlerësimin tonë të thellë për popullin dhe udhëheqjen e Republikës së Shqipërisë për solidaritetin e treguar në mbështetje të popullit palestinez dhe kauzës së tij të drejtë, për arritjen e të drejtave legjitime të lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit në trojet e Palestinës, me kryeqytet Jeruzalemin Lindor. Pranoni, Shkëlqesi, sigurimet e konsideratës sime më të lartë”, shkruhet në mesazhin e urimit për znj. Kodheli.

### **Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, z.Talat Xhaferi, letër urimi znj.Mimi Kodheli, me rastin e zgjedhjes Zëvendësprezidentë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s**

**3 Dhjetor 2020** - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, z.Talat Xhaferi, i ka dërguar një letër urimi deputetes Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit të Politikës së Jashtëm, me rastin e zgjedhjes së saj si Zëvendësprezidentë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Z.Xhaferi e ka vlerësuar emërimin e znj. Kodheli në postin e rëndësishëm si një “hap i logjikshëm i zotimeve Tuaja shumëvjeçare dhe angazhimeve të frytshme përfaqësuese në pozita të ndryshme në nivelin qeveritar dhe parlamentar të Republikës së Shqipërisë”. Më tej Kryeparlamentari Xhaferi shprehet se: “Rrugëtimin tonë të anëtarësimit në Aleancë e filluam bashkë me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kroacisë, duke kaluar nëpër çaste të mira dhe të këqija, por duke punuar me sinqeritet dhe përkushtim për më të mirën e përgjithshme të përbashkët, për ndryshimin e perceptimit të partnerët tanë strategjikë për një rajon konsumues i intervenimeve dhe rajon i cili prodhon jostabilitet dhe pasiguri. Për fat të keq, anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për arsye mirë të njohura, u realizua shumë vite më vonë, Porë nga perspektiva e sotme, investimi i shteteve tona dhe zotimet tona personale si politikanë në procesin, kontribuuan që si vende të jemi komponentë aktivë dhe partnerë të respektuar në misionet e NATOS-s dhe ti ndajmë në mënyrë të barabartë vlerat dhe sfidat për të cilat zotohet Aleanca”, shkruan z.Xhaferi.Më tej duke u ndalur në situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, me të cilën po përballen të gjitha vendet e botës, ku përveç vështirësive në aspektin shëndetësor, ekonomik dhe human, ballafaqohen me sfida të shumta politike, luftarake dhe teknologjike, z. Xhaferi shpreh bindjen se vetëm me qasje të përbashkëta dhe të bashkërenduara mund të kalohen me sukses.“Besoj plotësisht se si Zëvendësprezidentë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s do të lini gjurmën Tuaj personale mbi këto procese dhe se do të siguroni dukshmëri më të madhe të rajonit dhe integrimin e saj më të gjerë si parakusht për prosperitet në Aleancë, sepse suksesin Tuaj në suazat e Asamblesë Parlamentare të NATO-s e konsiderojmë si sukses të përbashkët të kësaj pjesë të kontinentit evropian”, shkruan në letrën e urimit Kryeparlamentari Xhaferi.Znj.Kodheli ka marrë urime edhe nga trupi diplomatik i akredituar në Tiranë

## Aktivite parlamentare

**Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Europës seancë të përbashkët mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në çështjet e grave. Përhëndet Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, dhe Presidenti i Asamblesë Parlamentare të KiE, z. Rik Daems**

**4 Dhjetor 2020** - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, në përkrahje të nismës së Presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës z. Rik Daems, “Për forcimin e bashkëpunimit mes parlamenteve kombëtare gjatë krizës aktuale COVID-19”, mbështeti organizimin e seancës së përbashkët dëgjimore “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në çështjet e grave”, si një veprimtari e përbashkët e Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Qëllimi i kësaj nisme të Presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, z. Rik Daems, është që të gjitha parlamentet e vendeve anëtare të KiE të organizojnë dëgjesa në komisionet e përhershme parlamentare kushtuar tematikave të veçanta mbi ndikimin dhe pasojat e pandemisë COVID-19. Në seancë morën pjesë dhe përhëndetën Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, dhe Presidenti i Asamblesë Parlamentare të KiE, z. Rik Daems, si edhe Kryetari i Delegacionit Shqiptar në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, deputeti Ervin Bushati. Në fjalën e tij, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, vuri në dukje se “Përpjekjet që kemi bërë e po bëjmë si edhe rezultatet që kemi arritur për të nxitur pjesëmarrjen shoqërore, ekonomike e politike të grave e vajzave, janë domethënëse sepse shënojnë një zhvillim cilësor në kulturën dhe shoqërinë shqiptare. Por këto arritje nuk janë gjithmonë drejtvizore. Shpesh ato kërcënohen nga rreziqe, të cilat vijnë si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë shoqërisë. Një rrezik të tillë, të jashtëm, përfaqëson edhe pandemia e Covid-19, e cila, përveç pasojave shëndetësore dhe ekonomike, ndikoi në pozitën e grave e vajzave në shoqëri e familje. Pandemia po ndikon në mënyrë kapilare, horizontale e vertikale, në të gjithë shoqërinë. Ajo imponon ndryshime, korrigjime, ridimensionim e mohime, të domosdoshme për të garantuar mbijetesën e shoqërisë ndaj këtij rreziku dhe rreziqeve anësore që e shoqërojnë. Është detyra jonë të kontribuojmë për të shmangur apo pakësuar këtë ndikim, në mënyrë që gratë dhe vajzat e Shqipërisë, gratë dhe vajzat e Europës, gratë dhe vajzat kudo në planet, të gëzojnë kënaqësitë e jetës normale dhe të kontribuojnë në mirëqenien e pjesëmarrjen e tyre në jetën shoqërore, në tregje dhe jetën ekonomike, në institucionet dhe vendim-marrjen politike.” Presidenti i Asamblesë Parlamentare të KiE, z. Rik Daems, në fjalën e tij falenderoi Kuvendin e Shqipërisë për organizimin e kësaj seance si edhe vlerësoi përpjekjet e Kuvendit të Shqipërisë për mbështetjen ligjore dhe lehtësimin e pasojave të pandemisë, sidomos ndaj grave e vajzave. Seanca u moderua nga Zëvendëskryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi, e cila vuri në dukje se pandemia e shkaktuar nga COVID-19 ka ndikuar dhe po ndikon në shumë aspekte të jetës, ekonomisë dhe aspektin social. Ajo po vë në ngarkesë të plotë shërbimet shëndetësore në të gjithë vendin dhe ka rritur nevojën për shërbime dhe investime të disa sektorë. Në seancë morën pjesë dhe paraqitën vlerësimet e tyre mbi ndikimin e pandemisë së COVID-19 në çështjet e grave në Shqipëri, Znj. Zita Gurmai, Raportuese e Asamblesë Parlamentare të KiE për Dhunën ndaj Grave; Dr. Aurela Bozo, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare; dhe Znj. Iris Luarasi, Zëvendëspresidente e organizatës GREVIO. Konkluzionet e seancës u bënë nga deputetja Eglantina Gjermeni, Kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, dhe anëtare e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

## Aktivite të Kryetarit të Kuvendit



### 2 dhjetor 2020

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, uron kryeparlamentarin rumun Ciolacu, për Festën Kombëtare: Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi dypalësh, aktualisht në momentin më të mirë

### 2 dhjetor 2020

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, priti Ambasadoren e re të Francës, znj. Elisabeth Barsacq: Franca do të bëjë ç'është e mundur që Shqipëria t'i bashkohet BE



### 3 dhjetor 2020

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, priti Ambasadorin e ri të Spanjës, z. Marcos Alonso Alonso: Mirënjohje për mbështetjen e Spanjës integritimit europian të Shqipërisë

## Mesazhe të Kryetarit të Kuvendit

### **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ngushëllime për ndarjen nga jeta të ish deputetit Marko Bello: Iku një zë i fuqishëm qytetar dhe i qytetarëve**

**4 dhjetor 2020** - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ka shprehur sot dhimbjen për ndarjen nga jeta të ish deputetit Marko Bello. “Sot iku Marko Bello. Familja humbi njeriun më të dashur, bashkëshortin dhe prindin, mungesa e të cilit do t’u shkaktojë një dhimbje të thellë. Ne humbën shokun, mikun dhe kolegun tonë të rrallë e të respektuar. Shqipëria humbi një personalitet që i ka shërbyer me devocion si deputet për tre legjislatura, si ambasador, si ministër e si profesor. Por mbi të gjitha, të gjithë humbëm një qytetar të denjë e patriot të madh. I zgjedhur tri herë si deputet, Marko ishte një zë i fuqishëm qytetar dhe i qytetarëve në Kuvendin e Shqipërisë. Ka drejtuar me kompetencë e përkushtim disa komisione parlamentare dhe i ka dhënë nder, dinjitet e hijeshi figurës së deputetit të Kuvendit Shqipërisë. Ndaj dhimbjen e thellë për humbjen e Markos dhe, në emër të Kuvendit të Shqipërisë, u shpreh familjes dhe të afërmeve ngushëllimet më të sinqerta.”, shkruan në mesazhin e tij të ngushëllimit Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi..

### **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, mesazh ngushëllimi për ndarjen nga jeta të themeluesit të TV Fax News, Kasem Hysenbelliu**

**5 dhjetor 2020** – Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ka sot një mesazh ngushëllimi për ndarjen nga jeta të themeluesit të TV Fax News, Kasem Hysenbelliu. “Ndaj dhimbjen me nënën, bashkëshorten dhe fëmijët e Kasëmit, në ditën më të rëndë të jetës së tyre. Kasëm Hysenbelliu do ta kujtojmë e nderojmë përgjithmonë si një qytetar i denjë i Shqipërisë, si një kontribuues mendjehapur i konsolidimit të medias së lirë, në shërbim të interesit publik e qytetar, si një sfidant i vështirësive për t’iu përkushtuar vendit, shoqërisë dhe qytetarëve. Lamtumirë, Kasem, miku ynë i shtrenjtë!”, shkruan në mesazhin e tij të ngushëllimit Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi..

### **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, uron kryeparlamentaren finlandeze Vehviläinen, për Ditën e Pavarësisë: Vlerësojmë kontributin e spikatur të Finlandës në mbështetje të paqes, sigurisë e stabilitetit**

**6 dhjetor 2020** - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i ka dërguar një letër urimi Kryetares së Parlamentit të Finlandës, znj. Anu Helena Vehviläinen, me rastin e Ditës së Pavarësisë. “Në emër të Kuvendit të Shqipërisë si edhe në emrin tim personal Ju dërgoj urimet më të ngrohta me rastin e Festës Kombëtare, 103-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Finlandës. Shpallja e pavarësisë së Finlandës prej Senatit më 4 dhjetor si edhe Deklarata e Pavarësisë që e pasoi, e miratuar nga Parlamenti më 6 dhjetor 1917, ishte një ngjarje historike për Finlandën dhe hapën rrugën për zhvillimin e modernizimin e Finlandës dhe rritjen e mirëqenies së popullit finlandez. Finlanda është sot një anëtare aktive e Bashkimit Europian, partnere e rëndësishme e NATO-s dhe mike e Shqipërisë. Marrëdhëniet dypalëshe janë shumë të mira dhe ato vijnë duke u forcuar. Ne vlerësojmë kontributin e spikatur të Finlandës në mbështetje të paqes, sigurisë e stabilitetit në botën e sotme të trazuar. Shqipëria i është mirënjohëse Finlandës për mbështetjen e vazhdueshme të procesit integruar-anëtarësues në Bashkimin Evropian, duke nisur me mbështetjen për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, marrjen e statusit të vendit kandidat dhe në vijim për vendimin për çeljen e negociatave. Vendimi i Këshilli i Bashkimit Europian i 25 marsit 2020 është rezultat edhe i kontributit të Parlamentit dhe Qeverisë së Finlandës, kontribut që populli shqiptar nuk do ta harrojë. Ne ndjekim me vëmendje përpjekjet e suksesshme të popullit dhe të institucioneve të Finlandës për përballimin e pasojave të pandemisë Covid-19, përpiqemi të përfitojmë nga kjo përvojë dhe urojmë që popujt tanë dhe gjithë njerëzimi të dalin sa më shpejt dhe sa më lehtë prej saj.”, shkruan Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.